



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:068207

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876257

KPPP.nr.905/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Komuna e Gjakovës”, me seli në Gjakovë, kundër debitorit N.H.T “Shkugëza”, me NRB: 70803356, me seli në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Prek Kola, avokat nga Gjakova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.269/23 të datës 15.05.2023, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.H.T “Shkugëza”, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.269/23 i datës 15.05.2023, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Komuna e Gjakovës”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.269/23 të datës 15.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës Nr. ser. 95612/2022 të datës 28.12.2022; Faturës Nr.ser.89310/2022 të datës 29.11.2022; Faturës Nr.ser.81403/2022 të datës 27.10.2022; Faturës Nr.ser.72387/2022 të datës 23.09.2022; Faturës Nr.ser.69669/2022 të datës 25.08.2022; Faturës Nr.ser.60175/2022 të datës 25.07.2022; Faturës Nr.ser.52597/2022 të datës 28.06.2022; Faturës Nr.ser.41536/2022 të datës 24.05.2022; Faturës Nr.ser.32744/2022 të datës 28.04.2022; Faturës Nr.ser.26361/202 të datës 06.04.2022; Faturës Nr.ser.23125/2022 të datës 28.03.2022; Faturës Nr.ser.6769/2023 të datës 26.01.2023; Faturës Nr.ser.60113/2017 të datës 23.06.2017; Faturës Nr.ser.77610/2017 të datës 11.08.2017; Faturës Nr.ser.90286/2017 të

datës 13.09.2017; Faturës Nr.ser.107991/2017 të datës 08.11.2017; Faturës Nr.ser.11061/2018 të datës 02.02.2018; Faturës Nr.ser.11057/2018 të datës 02.02.2018 dhe Faturës Nr.ser.49109/2018 të datës 01.06.2018; me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura, brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 22,960.00 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtu që të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të zyrës përbarimore të përbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, zyra përbarimore të zbatoj përbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se borxhi nuk është i saktësuar se për cilin vit ka mbetur pa u paguar. Më tutje ka shtuar se shuma e qirasë në vlerën prej 22,960.00 € nuk është e saktë, sepse debitori ka paguar qiranë dhe ka mbetur vetëm një shumë e vogël pa u paguar. Ka theksuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-se dhe se lidhur me këtë procedurë është duke u zhvilluar kontest gjyqësor në Gjykatën Komerciale për vërtetimin e bazës juridike rreth borxhit, qirasë së pa paguar si dhe për bazën për shkëputjen e kontratës. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të lihet jashtë fuqisë urdhri për përbarim, të revokohen të gjitha veprimet përbarimore, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapsim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar ndër të tjerash se i njëjti është vetëm deklarativ dhe nuk përmban asnjë provë konkrete me anë të së cilës do të gjente mbështetje në ligj. Më tutje ka deklaruar se Dhomat e shkallës së parë dhe të dytë të Gjykatës Komerciale i'a kanë refuzuar si të pabazuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pathemeltë prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. ser. 95612/2022 e datës 28.12.2022; Fatura Nr.ser.89310/2022 e datës 29.11.2022; Fatura Nr.ser.81403/2022 e datës 27.10.2022; Fatura Nr.ser.72387/2022 e datës 23.09.2022; Fatura Nr.ser.69669/2022 e datës 25.08.2022; Fatura Nr.ser.60175/2022 e datës 25.07.2022; Fatura Nr.ser.52597/2022 e datës 28.06.2022; Fatura Nr.ser.41536/2022 e datës 24.05.2022; Fatura Nr.ser.32744/2022 e datës 28.04.2022; Fatura Nr.ser.26361/202 e datës 06.04.2022; Fatura Nr.ser.23125/2022 e datës 28.03.2022; Fatura Nr.ser.6769/2023 e datës 26.01.2023; Fatura Nr.ser.60113/2017 e datës 23.06.2017; Fatura Nr.ser.77610/2017 e datës 11.08.2017; Fatura Nr.ser.90286/2017 e datës 13.09.2017; Fatura Nr.ser.107991/2017 e datës 08.11.2017; Fatura Nr.ser.11061/2018 e datës 02.02.2018; Fatura Nr.ser.11057/2018 e datës 02.02.2018 dhe Fatura Nr.ser.49109/2018 e datës 01.06.2018, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht te njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se janë pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, te njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.905/23, datë 28.06.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.